

Prof. Bajram Berisha nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë është zgjedhur “Profesor vizitor” në Universitetin Teknik të Munihut.

Bajram Berisha është Profesor ordinar në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë të Universitetit të Prishtinës (UP). Studimet themelore i ka mbaruar në Universitetin e Prishtinës (UP), studimet pasuniversitare në Universitetin e Lubjanës (Slloveni), e disertacionin e doktoratës në Universitetin Teknik të Munihut (TUM) në Gjermani. Pas habilitimit (2007) në fushën e fiziologjisë animale dhe bioteknologjisë është emëruar profesor i asociuar në TUM (Gjermani). Në 2011-ën është zgjedhur Profesor edhe në Universitetin Bujqësor të Tiranës (Shqipëri).

Prej vitit 1996 - 2008 Prof. Berisha ka punuar në Universitetin Teknik të Munihut në Gjermani (<http://physio.wzw.tum.de/index.php?id=299>).

Pas kthimit të tij në Kosovë (2008), Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës e Bavarisë vazhdimisht e ka përzgjedhur “Profesorit vizitor” në programe të ndryshme në kuadër të Universitetit Teknik të Munihut (<http://physio.wzw.tum.de/index.php?id=299>). Gjatë këtij semestri Prof. Berisha është angazhuar në Universitetin Teknik të Munihut në kuadër të programit të veçantë “Iniciativa e ekselencës”. Universiteti Teknik i Munihut, është i pari në listën e universiteteve më të mira të Gjermanisë dhe i 47 në listën e Universiteteve më të mira në botë (shih <http://www.shanghairanking.com>). Prandaj, angazhimi dhe aktiviteti i Prof. Berishës në këtë universitet të famshëm evropian konsiderohet një kontribut i rëndësishëm në ngritjen e reputacionit dhe ndërkombëtarizimin e Universitetit të Prishtinës dhe të arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor në Kosovë.

Lidhur me aktivitetin e Prof. Berishës në cilësinë e “Visiting Professor” në Universitetin Teknik të Munihut në Gjermani më shumë mund të shihni në intervistën e tij dhënë këto ditë agjencisë se lajmeve Kosovapress dhe që u emitua edhe në disa media tjera të shkruara dhe vizive.

<http://www.kosovapress.com/sq/lajme/bajram-berisha-perzgjedhet-profesor-vizitor-ne-universitetin-e-munihut-102933/>

<http://www.botasot.info/kosova/657009/bajram-berisha-perzgjedhet-profesor-vizitor-ne-universitetin-e-munihut/>

<http://www.arbresh.info/lajmet/bajram-berisha-perzgjedhet-profesor-vizitor-ne-universitetin-e-munihut/>

<http://www.rtklive.com/sq/news-single.php?ID=139014>